



02/Nr. 3519 /2021

Datë: 17.05.2021

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 57 të Statutit të komunës së Hanit të Elezit, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, merr këtë:

ANEKS V E N D I M

1. Aprovohen, (I) Procedura standarde e operimit për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare nën 1,000€ dhe (II) Procedura standarde e operimit për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare kapitale mbi 1,000€, si pjesë përbërëse e Doracakut “Libri i Proceseve për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike” me nr. protokollit 02/Nr.94023/2020, i cili përmban komponentët/proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Këto procedura standarde të operimit do të shërbejnë si procedura të brendshme për evidentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me rregullën financiare.
2. Pjesë përbërëse e këtij aneks vendimi janë (I) Procedura standarde e operimit për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare nën 1,000€ dhe (II) Procedura standarde e operimit për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare kapitale mbi 1,000€.
3. Për zbatimin e këtij aneks vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.
4. Aneks vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me këtë Aneks Vendim njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës

